**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**AGJENCIA KOMBËTARE E MJEDISIT**

Tiranë më 31 .12.2024

# REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

# DHJETOR 2024

<table>
<tr>
<td>1.</td>
<td>28.11.2024</td>
<td>Vënie në dispozicion të dokumenta-ve / informacion-eve zyrtare në lidhje me nivelin e ndotjes në lumin Drin ( Drin i Bardhë,Drin</td>
<td>13.12.2024</td>
<td>1-Baseni i Drinit monitorohet në 6 stacione kampionimi që nga stacioni i referencës, burimi i tij deri para derdhjes në det.<br><br>Stacionet janë paraqitur në formë tabelare si vijon:<br>
<table>
<tr><th>Nr.</th><th>Kodi i kampionit</th><th>Emërtimi i Lumit</th><th>Vendndodhja</th><th>Koordinatat gjeografike</th></tr>
<tr><td>1.</td><td>D1</td><td>Drini i Zi</td><td>Topojan – Ura Burrel Peshkopi</td><td>N 41.58062<br>E 20.43423</td></tr>
<tr><td>2.</td><td>D2</td><td>Drini</td><td>Bahçallek– Ura Bahçallek</td><td>N 42.04177<br>E 19.49080</td></tr>
</table>
</td>
<td>Përfunduar</td>
<td>Nuk ka</td>
</tr>
</table>

<table>
<tr>
<td></td>
<td></td>
<td>i Zi,<br>kaskada e<br>Drinit dhe<br>rrjedha drejt<br>Adriatikut)<br>?</td>
<td></td>
<td>
<table>
<tr><td>3.</td><td>D3</td><td>Drini i Bardhë</td><td>Luma - Kukës</td><td>N 42.040408<br>E 20.274955</td></tr>
<tr><td>4.</td><td>Bu1</td><td>Buna</td><td>Muriqan – afër fshatit, në kufi</td><td>N 42.009313<br>E 19.411012</td></tr>
<tr><td>5.</td><td>Bu2</td><td>Buna</td><td>Ura e vjetër Shkodër - Shirokë</td><td>N 42.045851<br>E 19.487121</td></tr>
<tr><td>6.</td><td>DLe</td><td>Drini Lezhë</td><td>Kune – Vain para derdhjes në det</td><td>N 41.753554<br>E 19.593363</td></tr>
</table>
Monitorimi kryhet 4 herë/vit në përputhje me Direktivën Kuadër të Ujit. Të dhënat e monitorimit dhe raporti janë të aksesueshme në faqen zyrtare të AKM https://akm.gov.al/raporte-dhe-publikime/
2-Trajtimi i ujerave të ndotura nuk është në kompetencën e AKM por të një institucioni tjetër, AKUK
3-Sigurisht, që ndotja ka impakt negativ në florën dhe faunën e ekosistemeve ujore dhe AKM në përfundim të realizimit të monitorimit, përpunon të dhënat dhe identifikon pikat e monitorimit ku tejkalojnë normat e lejuara dhe vlerëson shkaqet e ndotjes, si dhe duke dhënë rekomandime.
AKM me anë të shkresave zyrtare njofton bashkitë përkatëse me problematikat e identifikuara në terren.
4-Ndërsa përsa i përket pikës 4, mbështetur në Vendimin Nr. 568 datë 17.07.2019 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, si dhe në zbatim të Ligjit Nr. 10 433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin ne Republikën e Shqipërisë”, të Ligjit Nr. 10448
</td>
<td></td>
<td></td>
</tr>
</table>

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, Agjencia Rajonale e Mjedisit Shkodër, Lezhë,Kukës, kryen inspektime të programuara për subjektet që janë të pajisuara me leje mjedisi të tipit A dhe B, si dhe me indicje nga palët e treta.<br>Në këto kushte, ju bëjmë me dije se nuk kemi patur ankesa as nga subjekte private dhe as qytetarë lidhur me situatën e lumit Drin përsa i përket nivelit të ndotjes.<br>Institucioni ynë ka marrë pjesë në aksione pastrimi të mbetjeve përgjatë vijës lumore të lumit Drin në Bashkinë Kukës. | | |
| 2. | 02.12.20 24 | Praktikat e inspektimit të Albpetrol për vitet 2020-2023 dhe nga 1 Janari 2024 – 28 Tetor 2024? | 04.12.2024 | Referuar Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e Informimit “ i ndryshuar, Ligjit Nr.10433 “Për Inspektim në Republikën e Shqipërisë dhe kërkesës tuaj me objekt “ kërkesë për informacion dhe vënie në dispozicion e dokumentacionit" protokolluar pranë ARM Fier/Vlore/Gjirokaster me Nr.3069 Prot, datë: 07.11.2024 lidhur me praktikat e Inspektimit ndaj Subjektit për vitet 2020-2024, Po ju vendosim ne dispozicion Informacionin/ dokumentacionin e kërkuar | Përfunduar | Nuk ka |
| 3. | 24.11.20 24 | Bashkangjit-ur do të gjeni të gjitha dokumenta-tat që kompania B*** shpk në bashkëpu-nim me | 16.12..2024 | Në përgjigje të email-it tuaj, si dhe në zbatim të legjislacionit mjedisor në fuqi, ligjit Nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, ligjit Nr. 10 463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, ligjit Nr.10 448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, Vendim Nr. 402, datë 30.6.2021 “Për miratimin e katalogut të mbetjeve”, VKM Nr. 229, datë 23.04.2014 “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe informacionit që duhet të përfshihet në dokumentin e transferimit”, VKM Nr. 371, datë 11.6.2014 “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | G*** Constru-ction disponojnë përsa i përket procedurës së asgjësimit të produkteve ushqimore dhe lëngje.<br><br>Ju lutem, një konfirmim nëse dokumentat janë konform ligjeve për vazhdimin e procedurës së asgjësimeve ? | | të rrezikshme dhe të dokumentit të dorëzimit të tyre", si dhe VKM Nr. 568, datë 17.07.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit", ju bëjmë me dije si më poshtë:<br>Për të kryer një procedurë asgjësimi subjekti këkrkues duhet të jetë i pajisur me kontratë bashkëpunimi me një subjekt që do të kryej transportin, magazinimin, rikuperimin dhe asgjesimin e këtyre mbetjeve në zbatim të pikës 5 të Nenit 21 dhe të Neneve 57, 58 të Ligjit Nr. 10463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", si dhe të kryejë klasifikimin e mallrave të skaduara dhe mbetjeve të tjera që konsiderohen mbetje sipas Vendim Nr. 402, datë 30.6.2021 "Për miratimin e katalogut të mbetjeve", me kodet përkatëse.<br>Subjekti kontraktues duhet të jetë i pajisur me lejet dhe licencat përkatëse për kryerjen e procedurës së transportit (Licence III2B) dhe procedurës së asgjësimit (Leje Mjedisi me kodet përkatëse), të publikuar gjithashtu në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve.<br><br>Referuar pyetjes nëse dokumentat janë konform ligjeve për vazhdimin e procedurës së asgjesimeve ju bëjmë me dije se subjekti "Brema Ambiente" shpk dhe "Gant Construction" shpk janë të pajisur me leje dhe licenca për kryerjen e procedurave të transportit dhe asgjesimit të mbetjeve, por verifikimi dhe përshtatja e kodeve me produktet e destinuara për asgjesim do të kryhet nga grupi përkatës i pranishëm në procedurën e asgjesimit ne vendin dhe orën e përcaktuar nga ana juaj. | | |
| 4. | 10.12.2024 | 1-Sa inspektime janë kryer nga AKM në subjektin KURUM me objekt: "Zbatimi i | 13.12.2024 | Në përgjigje të kërkesës së dërguar në formë elektronike më datë 13 Dhjetor 2024 si dhe administruar në AKM "Kërkesë për vënien në dispozicion dokumentacionin e transfertave të KURUM për mbetjet e rrezikshme", bashkëlidhur do të gjeni rregjistrin e transfertave të mbetjeve të rrezikshme për vitin 2024 në të dyja periudhat e raportimit Nëntor2023- Maj 2024 si dhe Maj 2024-Nëntor 2024. | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | lejes mjedisore”<br><br>2- Ju lutem na vini në dispozicion këto raporte inspektimi.<br><br>3- Na vini në dispozicion raportin e inspektimit të kryer në kompaninë KURUM në muajin shtator 2024 me objekt: “Zbatimi i lejes mjedisore” dhe dokumentin e masës administrati-ve për pezullim të aktivitetit të transferimit të mbetjeve të rrezikshme” | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 4- A ka AKM një Regjistër Kombëtar të Transfertave të Mbetjeve të Rrezikshme, bazuar në VKM Nr.371 (2014) dhe a ka raportuar kompania KURUM për transfertat e saj të mbetejeve të rrezikshme sipas kritereve të përcaktuara në këtë VKM?<br><br>5- Sa transferta ka raportuar KURUM në këtë regjistër dhe a kanë qenë këto raportime brenda afatit | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kohor të përcaktuar në dispozitat ligjore?<br><br>6- Nëse kjo s'ka ndodhur, cilat kanë qenë veprimet e ndërmarra nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit ndaj kompanisë? | | | | |
| 5. | 10.12.2024 | Në raportet e monitorimit nga AlbPetrol nuk janë vendosur në dispozicion emrat e kompanive që kanë bërë transportin e mbetjeve të rrezikshme drejt zonave të groposjes | 23.12.2024 | Në vijim të informacionit të kërkuar, në lidhje me emrat e kompanive për transportin e mbetjeve të rrezikshme,<br><br>Në vijim të komunikimit Ju bëjmë me dije se nga ana e Sektorit të Monitorimeve është vënë në dispozicion me CD, cdo informacion që disponohet në vite për subjektet e kërkuara. I gjithë materiali prej 17.8Gb u sistemua në 7 CD. **Pra cfarë disponohet, është vënë në dispozicion të kërkuesit.**<br><br>Subjekti ALBPETROL sh.a. nuk ka raportuar periodikisht pranë AKM dhe për këtë qëllim janë dërguar shkresa lajmëruese, (bashkelidhur e-mailit). Që nga ky moment subjekti solli raportet e vetëmonitorimit.<br>Bazuar në periudhën e raportimeve, ende nuk ka ardhur data për të sjellë raportin vjetor, ku një nga kapitujt është pjesa e mbetjeve, për të cilin Sektorit i Monitorimeve vihet në dijeni. Në | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | ose landfilleve. Do ju lutesha të merrnit një sqarim nga AlbPetrol ose ndoshta ka ndodhur ndonjë gabim në vendosjen në dispozicion të informacio-nit. | | këtë kapitull sqarohet mënyra e menaxhimit të mbetjeve, por nuk përcaktohet nëse Sektori i Informacionit, Statistikave Mjedisore dhe GIS bën me dije si më poshtë:<br>Subjekti AlbPetrol nuk është i pajisur me Kod Unik dhe nuk ka detyrim raportimi pranë Sektorit të Informacionit, Statistikave Mjedisore dhe GIS të raportojë mbi regjistrat e transfertave të mbetjeve, detyrim ky sipas VKM Nr.229/2015 dhe VKM Nr.371/2014, të ndryshuara. Gjithashtu theksojmë se nga verifikimi i rregjistrit të transfertave të raportuara për vitin 2024 nga operatorët e pajisur me Kod Unik, asnjë prej tyre nuk ka deklaruar se ka trajtuar mbetje të subjektit Albpetrol.<br><br>Gjithashtu bazuar ne KUSHTI 8 – MENAXHIMI I MBETJEVE, Të gjitha të dhënat e regjistruara që lidhen me menaxhimin e mbetjeve duhet t'i vihen në dispozicion për inspektim autoritetit kompetent. Sektori i Monitorimeve nuk ka funskion inspektues.<br>**Për sa më sipër, cdo gjë që subjekti ka dorëzuar në AKM me CD, lidhur me monitorimet, pra cfarë disponohet në arkivën e AKM, i është vënë në dispozicion kërkuesit Z. Armand Kullau, (me CD copy and paste).**<br>Në lejen e ALBPETROL SH.A (LC-9988) me Nr.5818 prot datë 09.07.2018 me Nr. Identifikimi të Lejes 2817 me K.Nr.25 për Leje Mjedisi Tipi A – Nxjerrja e naftës dhe e gazit natyror, Kushti 8-Menaxhimi I Mbetjeve në piken 8.7 citon:<br><br>Të gjitha të dhënat e regjistruara që lidhen me menaxhimin e mbetjeve duhet ti vihen ne dispozicion per inspektim autoritetit kompetent. Këto të dhena duhet të përmbajne si minimum elementet e mëposhtem:<br><br>• Sasinë dhe Kodet KEM (EWC) për mbetjen ne tabelën 4.1.1 te Shtojcës 4.1 mbi Asgjësimin/Trajtimin e Mbetjeve të Rrezikshme dhe Tabelen 4.1.2 te shtojcës 4.1 mbi Asgjësimin/Trajtimin e Mbetjeve ne kete leje. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | <ul><li>**Emrin e grumbulluesit te mbetjeve dhe transportuesit dhe detajet lejeve/licensave/autorizimeve te tyre (perfshire autoritetin leshues)**</li><li>Detaje rreth instalimit per asgjësimin/trajtimin përfundimtar të mbetjeve dhe pajtueshmërine e instalimit për asgjësimin/trajtimin e mbetjeve të dorezuara, detajet e lejes/licences/autorizimit dhe detajet për autoritetin lëshues.</li><li>Konfirmimin me shkrim për pranimin dhe asgjësimin/trajnimin të cdo dërgese mbetjesh jashtë vendndodhjes.</li><li>Detajet për cdo dërgesë jashtë vendit për qëllim të trajtimit të përcaktuar si “të listës së gjelbër” në baze te rregullores se KEE Nr.259/1993 dhe amendamenteve te saj. Arsyetimi mbi klasifikimin duhet te perbeje nje pjese integrale te dokumentacionit.</li><li>Te dhënat për të gjitha dërgesat e refuzuara</li><li>Detaje për të gjitha përzierjet e miratuara të mbetjeve në perputhje me kushtet e pikës 8.6.</li></ul>Në lejen e ALBPETROL SH.A (LC-7918) me Nr.3727 prot datë 04.05.2018 me Nr. Identifikimi të Lejes 2784 me K.Nr.14 për Leje Mjedisi Tipi B – Fonderite e metaleve ferrose.Shkrirja dhe perfitimi i metaleve jo ferroze (me ngjyrë) përfshirë produktet e rikuperuara (duke përfshirë rafinimin dhe derdhjen në fonderi). Trajtime Sipërfaqësore të metaleve, plastikave, duke përdorur procese elektrolitike dhe kimike. Kushti 8-Menaxhimi I Mbetjeve në pikën 8.10 citon:<br><br>Të gjitha të dhënat e regjistruara që lidhen me menaxhimin e mbetjeve duhet ti vihen në dispozicion për inspektim autoritetit kompetent. Këto të dhena duhet të përmbajne si minimum elementet e mëposhtem: | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | • Sasinë dhe Kodet KEM2 (EWC) për mbetjen në tabelën 4.1.1 te Shtojcës 4.1 mbi Asgjësimin/Trajtimin e Mbetjeve të Rrezikshme dhe Tabelen 4.1.2 te shtojcës 4.1 mbi Asgjësimin/Trajtimin e Mbetjeve ne kete leje.<br>• **Emrin e grumbulluesit të mbetjeve dhe transportuesit dhe detajet lejeve/licensave/autorizimeve të tyre (përfshirë autoritetin lëshues)**<br>• Detaje rreth instalimit për asgjësimin/trajtimin përfundimtar të mbetjeve dhe pajtueshmërine e instalimit për asgjësimin/trajtimin e mbetjeve të dorëzuara, detajet e lejes/licences/autorizimit dhe detajet për autoritetin lëshues.<br>• Konfirmimin me shkrim për pranimin dhe asgjësimin/trajnimin të cdo dërgese mbetjesh jashtë vendndodhjes.<br>• Detajet për cdo dërgesë jashtë vendit për qëllim të trajtimit të përcaktuar si “të listës së gjelbër” në bazë të rregullores së KEE Nr.259/1993 dhe amendamenteve të saj. Arsyetimi mbi klasifikimin duhet të përbëjë një pjesë integrale të dokumentacionit.<br>• Të dhënat për të gjitha dërgesat e refuzuara<br>• Detaje për të gjitha përzierjet e miratuara të mbetjeve në perputhje me kushtet e pikës 8.6.<br><br>Nga sa më sipër Z. Kullau kërkon informacionin e kushtit 8.7 që është pjesë e raportit të Vetmonitorimit që ka detyrim operatori.<br><br>Subjekti AlbPetrol nuk është i pajisur me Kod Unik dhe nuk ka detyrim raportimi pranë Sektorit të Informacionit, Statistikave Mjedisore dhe GIS të raportojë mbi regjistrat e transfertave të | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | mbetjeve detyrim ky sipas VKM Nr. 229/2015 dhe VKM Nr. 371/2014, t ndryshuara.<br><br>Gjithashtu theksojme se nga verifikimi i rregjistrit te transfertave te raportuara per vitin 2024 nga operatoret e pajisur me Kod Unik, asnje prej tyre nuk ka deklaruar se ka trajtuar mbetje të subjektit Albpetrol. | | |
| 6. | 13.12.2024 | 1-Sa inspektime janë kryer nga AKM në subjektin KURUM me objekt: "Zbatimi i lejes mjedisore"<br><br>2- Ju lutem na vini në dispozicion këto raporte inspektimi.<br><br>3- Na vini në dispozicion raportin e inspektimit të kryer në kompaninë KURUM në muajin Shtator 2024 me | 19.12.2024 | Në përgjigje të kërkesës së dërguar, në formë elektronike më datë 13 Dhjetor 2024 si dhe administruar në AKM me anë të shkresës me Nr. 13090 Prot, date 16.12.2024 me lëndë "Kërkesë për vënien në dispozicion dokumentacionin e transfertave të KURUM për mbetjet e rrezikshme", bashkëlidhur do të gjeni rregjistrin e transfertave të mbetjeve të rrezikshme për vitin 2024 në të dyja periudhat e raportimit Nëntor2023- Maj 2024 si dhe Maj 2024-Nëntor 2024. | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | objekt: “Zbatimi i lejes mjedisore” dhe dokumentin e masës administra-tive për pezullim të aktivitetit të transferimit të mbetjeve të rrezikshme”<br><br>4- A ka AKM një Regjistër Kombëtar të Transfertave të Mbetjeve të Rrezikshme, bazuar në VKM 371 (2014) dhe a ka raportuar kompania KURUM për transfertat e saj të mbetejeve të rrezikshme sipas | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kritereve të përcaktuara në këtë VKM?<br><br>5- Sa transferta ka raportuar KURUM në këtë regjistër dhe a kanë qenë këto raportime brenda afatit kohor të përcaktuar në dispozitat ligjore?<br><br>6- Nëse kjo s'ka ndodhur, cilat kanë qenë veprimet e ndërmarra nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit ndaj kompanisë? | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 7. | 19.12.2024 | Në lidhje me aplikimin e subjektit "Koorporata Elektro-energjetike Shqiptare" sh.a, me nr.AN180120230008 aplikimi, datë 18/01/2023 në lidhje me procedurën për njoftim të procedurës së thelluar të VNM-së për projektin "Hidrocentrali i Skavicës", me vendodhje në luginën e Drinit të Zi. Subjektit e cila është refuzuar automatic-isht nga sistemi i e_lejeve, | 24.12.2024 | Referuar kërkesës për informacion në lidhje me subjektit "Koorporata Elektroenergjetike Shqiptare" sh.a, me nr. AN180120230008 aplikimi, datë 18/01/2023, për njoftim të procedurës së thelluar të VNM-së për projektin "Hidrocentrali i Skavicës", me vendodhje në luginën e Drinit të Zi.<br>*1.Nese subjekti Koorporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a ka riaplikuar për kryerjen e procedurës së*VNM-së së Thelluar.<br><br>Subjekti nuk ka riaplikuar për kryerjen e procedurës së VNM-së së Thelluar. | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | pas tejkalimit të afatit ligjor, desha të di nëse:<br><br>1. subjekti Koorporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a ka riaplikuar për kryerjen e procedu-rës së VNM-së së Thelluar.<br><br>2. Nëse po, mund të më nisni dokumentat përkatëse të aplikimit në | | | | |
| 8. | 23.12.2024 | Jam konsulente vendore e Grupit të Bankës Botërore, për projektin "Green | 26.12.2024 | E caktojmë në parim në fillim të Janarit, pra më datën 6 Janar 2025, nga ora 10.30? Gjithmonë nëse keni mundësi. | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Investment Climate Diagnostic" (GICD).<br><br>Në kuadër të këtij projekti duam të identifiko-jmë pengesat ligjore dhe rregullatore në zhvillimin e energjive të rinovuesh-me në Shqipëri.<br><br>Në fakt do të kërkoja mundësisht (i) një takim me personat përgjegjës, që merren me monitorimin e mjedisit në institucion, por paraprakisht , po iu | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dergoj (ii) disa pyetje:<br><br>1.Sa herë në vit raportoni dhe ku në lidhje me emetimet e GHG-ve?<br><br>2. A përdorni standardet e IPPC të 2019 për matjen e emetimevetë GHG-ve? Nëse jo çfarë metode përdorni?<br><br>3. A i mbështesni subjektet që janë të detyruara të bëjnë raportime në lidhje me klimën apo emetimet e GHG? Sa here në vit i bëjnë këto | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | raportime? A keni një model raportimi, që ata duhet të plotësojnë?<br><br>4. A ka protokolle për raportimet vullnetare? A keni të tilla si Protokolli i GHG-së?<br><br>5. A zbatoni standartet e përcaktuara nga TCFD 2021 ?<br><br>6. Për cilat çështje raportojnë subjektet e detyruara si më lart?<br><br>7. A i monitoroni subjektet nëse janë në përputhje | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | me legjislacionin mjedisor? Në ç'mënyrë dhe çfarë keni konstatuar?<br><br>8. A ka një nivel të përcaktuar për emetimet e GHG mbi të cilin më pas ka penalitet për subjektet? Në se po cili është? Cilat janë penalitetet?<br><br>9. Për çfarë përdoret e ardhura nga taksat e karbonit?<br><br>10. Cilat janë masat që keni ndërmarrë ose planifikuar | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | t'i zbatoni për t'i minimizuar emetimet e GHG-ve?<br><br>11. Gjithçka tjetër që ka të bëjë me monitorimet , raportimet e emetimeve të GHG-ve, si dhe bashkëpunimin me subjektet e detyruara për të raportuar për klimën. | | | | |
| 9. | 19.12.2024 | A ushtrohet veprimtari minerare me karrierë (gurore) në fshatin Berdicë (në zonën e mbrojtur dhe jashtë<br><br>saj)? Nëse po, a janë | 27.12.2024 | Në përgjigje të kërkesës së ardhur në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, ju informojmë që në fshatin Berdicë, Shkodër, **nuk ushtrohet veprimtari minerare "Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret " (guroret).** | Përfunduar | Nuk ka |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | dhënë leje mjedisore për ushtrimin e këtyre veprimtarive minerare me karrierë<br><br>(gurore)? Na vendosni në disposizion kopje të lejeve mjedisore dhe të gjithë dokumentacionit mbi të<br><br>cilat është miratuar leja mjedisore?<br><br>2. A janë ushtruar inspektimi në lidhje me veprimtarinë minerare me karrierë (guroret) në fshatin Berdicë? | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Nëse po ju lutem na vendosni në dispozicion nkopje të raporteve të inspektimeve të kryera.<br><br>3. A janë dorëzuar raporte dhe plane për rehabilimine mjedisit për veprimtarinëe kryer nga ana e<br><br>subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e veprimtarive minerare me karrierë (guroret) në fshatin Berdicë?<br><br>Nëse po ju lutem na vendosni në dispozicion kopje të | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | raporteve të dorëzuar?<br><br>4. A janë bërë studime në fshatin Berdicë në lidhje me nivelin e ndotjes, cënimin e faunës apo florës nga<br><br>ushtrimi i veprimtarisë minerare me karrierë (guroret)?<br><br>5. A janë marrë masa për rehabilitimin e zonës dhe mbrojtjene faunës dhe florës në këtë zonë? | | | | |